



Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut  
Municipal Istog  
Municipal Istog

05.Nr. 29/19  
Datë: 29.01.2019

Drejtoria për Arsim

Drejtoria Komunale për Arsim në Komunën e Istogut dukë u bazuar në neni 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 35 të Ligjit Nr.04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr.03/L-068 Për Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës,dhe në mbështetje të: UA-MPMS, Nr.07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik,UA-MASHT,nr.10/2018 Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, UA-MASHT,nr.02/2017 Për Vlefshmerinë e Programeve Studimore të Bartësve Privat të Arsimit të Lartë si dhe, references për aprovim të pozitive Nr.13-016-3339 të datës 25.01.2019 shpall këtë:

### KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës për mesimdhënës dhe Punëtor/e të stafit Teknik.

#### Në Shfmu "Hysni Zajmi" Vrellë

1. Një mesimdhënës/e për Mësim klasor (1-5) në paralelen e ndarë në Studenicë vendi i lirë i punës nga data 20.03.2019

#### Në Shfmu "Martin Camaj" Gurrakoc.

1. Një punëtor teknik (Pastrues/e) paralelja e ndarë Llukac i Thatë.

#### Në Shfmu "Trepça" Banjë

1. Një mesimdhënës/e për Gjuhë dhe Letersi Shqipe vendi i lirë i punës nga data 12.03.2019.

#### Në Shfmu "Avni Rrustemi" Zallq.

1. Një punëtor teknik (Pastrues/e) me mundësi transferi në Gjimnazin "Haxhi Zeka" në Istog.

#### Në Gjimnazin "Haxhi Zeka" në Istog.

1. Një mesimdhënës/e për Teknologji-Informatik (zëvendësim)

- Për vendin e punës punëtor/e teknik (Pastres/e) është obligative që kandidatet ta kenë të përfunduar shkollën e Mesme të Lartë.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilin e plotëson kandidati,
- Rezymeja personale (CV),
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit),
- Çertifikata e lindjes
- Kopja e diplomës e vërtetuar, ose certifikata në vend të diplomës e vërtetuar jo me e vjetër së gjashtë muaj gjdo certifikat me e vjetër së gjashtë muaj nga data e diplomimit nuk do të merret parasyshë.
- Kandidatët të cilët kanë diplomuar jashtë Republikës së Kosovës, duhet ti kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë,
- Dëshmitë e rikualifikimeve dhe trajnimeve të akredituara nga MASHT (nëse ka)
- Dëshmia që nuk jeni nën hetime ,
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim (nëse ka)

## II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-032) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHT-it (UA Nr. 10/2018) si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

Afati i konkursit mbetet i hapur prej datës 29.01.2019 deri më datën 12.02.2019.

Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, në hyrje të ndërtesës së Komunës, zyra Nr.100, kati përdhësë dhe dorëzohet i plotësuar së bashku me dokumentacionin përcjellës po në të njëjten zyre.

Dokumentacioni duhet të jetë në kopje, Komisioni i pranimit në rast dyshimi do të kërkon origjinalin në intervistë. Ky dokumentacion shërben deri në përfundim të procedurës së konkursit i njëjti nuk kthehet dhe as nuk ruhet. Dokumentacioni i pa kompletuar dhe ai i cili arrinë pas afatit nuk do të shqyrtohet gjithashtu kandidatët të cilët nuk e plotësojnë qartë dhe saktë formularin e aplikimit (kërkesën) do të refuzohet.

Në testin me shkrim do të ftohen vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriterët bazuar në aktet normative dhe legjislacionin në fuqi, kurse intervistës do ti nenshtrohen vetëm kandidatët të cilët arrin të kenë me shumë së 50% të kalushmeris se testit më shkrim.



Drejtori i DKA-së  
Harush Shoshi